HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/128
Datë: 29.08.2024

Mbështetur në Nenin 34 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Nenin 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087, si dhe në bazë të Nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Nenit 162 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A. në Mbledhjen Nr. 11, të mbajtur më 29.08.2024, njëzëri mori këtë:

VENDIM

I. Miratohet Draft-skema Organizative e HK-Trainkos Sh.A. sipas propozimeve të Menaxhmentit për rishikimin e saj.
II. Për zbatimin e skemës së re organizative, rekomandohet që Menaxhmenti të formojë një komision të veçantë profesional, i cili do të paraqesë propozimet konkrete për sistemimin e të punësuarve sipas ndryshimeve të dala nga procesi i ristrukturimit të Ndërmarrjes.
III. Sistemimi i të punësuarve të bëhet në përputhje me Rregulloren për Sistematizimin dhe Përshkrimin e Vendeve të Punës, bazuar në kritere të qarta, pa asnjë lloj anshmërie, diskriminimi apo favorizimi dhe në harmoni me ligjet dhe rregullativën tjetër të Ndërmarrjes.
IV. Të punësuarve të cilëve u janë shuar pozitat e punës, t'u jepet mundësia e sistemimit në pozitat tjera të mundshme, gjegjësisht sipas nevojave të Ndërmarrjes t'u mundësohet trajnimi dhe rikualifikimi.
V. Procesi i sistemimit të të punësuarve sipas skemës së re organizative të përfundojë deri më 31 tetor 2024.
VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Arsyetim

Marrë parasysh gjendjen e vështirë financiare dhe organizative të Ndërmarrjes dhe me qëllim të parandalimit të mëtejshëm të përkeqësimit të kësaj gjendje, është vlerësuar tejet i domosdoshëm procesi i ristrukturimit të Ndërmarrjes. Humbjet financiare të shkaktuara ndër vite dhe borxhet e shumta financiare ndaj institucioneve, operatorëve dhe partnerëve kanë qenë shkak për të vlerësuar ristrukturimin si një mundësi për sanimin e gjendjes së krijuar.
Në bazë të rekomandimeve të Bordit, një komision i veçantë, i emëruar me vendimin e Menaxhmentit Nr. 158, të datës 05.03.2024, ka vlerësuar nevojën për ristrukturim, e cila ka marrë mbështetjen e pothuajse të gjithë stafit në mbi tridhjetë (30) takimet e zhvilluara nga

komisioni. Pas vlerësimit të domosdoshmërisë së ristrukturimit, Bordi i Drejtorëve ka mbështetur këtë proces dhe ka rekomanduar që të bëhen përgatitjet dhe propozimet konkrete për rishikim të skemës organizative dhe në dokumentet tjera që janë ndikuar nga ndryshimet e skemës organizative: Rregulloren për Përshkrimin e Detyrave të Punës (e cila tani përfshinë edhe pjesën e sistematizimit që i ka munguar Ndërmarrjes), Udhëzimin për Përshkrimin e Detyrave për Departamente dhe Zyra, Rregulloren për Paga dhe Kompensimet Tjera si dhe dokumentet tjera të nevojshme. Duke u bazuar në propozimet dhe arsyetimet e Menaxhmentit dhe duke e vlerësuar si të domosdoshme ndërmarrjen e masave për përmirësimin e gjendjes financiare të Ndërmarrjes dhe krijimin e kushteve për rimëkëmbjen e saj, Bordi i Drejtorëve ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues

Iu dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv
- Aksionarit – NJPMNP
- Departamentit të Administratës
- Arkivit